

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8018
E premte, 21 mars 2025
Çmimi 0.50

Policia thotë se ka
përmbushur me sukses
misionin për ruajtjen e rendit
e të qetësisë publike në vend

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTI I LETONISË NË PRISHTINË: MASAT E BE-së NDAJ KOSOVËS DUHET TË HIQEN, SA MË SHPEJT, AQ MË MIRË

FAQE 4-5



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, sërisht ka bërë thirrje për heqjen e masave ndëshkuese të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës, ndërsa homologu i saj nga Letonia, Edgars Rinkevics,

ka thënë se shteti që udhëheq ai është në të njëjtën linjë. Ata i kanë bërë këto komente në një konferencë të përbashkët për medie të enjten në Prishtinë. "Diskutuam edhe

për heqjen e masave ndaj BE-së. Qëndrimi i vendit tim është që BE-ja duhet t'i heqë ato masa kufizuese. Sa më shpejt që bëhet kjo, aq më mirë", ka thënë Rinkevics

A PO FORMOHET NJË ALEANCË USHTARAKE NË BALLKAN?

F.3



PZAP-i REFUZON KATËR ANKESAT E SUBJEKTEVE POLITIKE PËR REZULTATIN PËRFUNDIMTAR TË ZGJEDHJEVE

F.7



AKTUALE



PLLENKOVIC: BE-JA DUHET T'I KUSHTOJË MË SHUMË VËMENDJE MUNGESËS SË STABILITETIT NË BALLKAN

F.2

U JEPET LAMTUMIRA 59 VIKTIMAVE TË KOÇANIT

F.2

PROKURORIA E PEJËS KOORDINOHET ME INSTITUCIONET PËR SIGURINË NË SHKOLLA

F.6

EKONOMI



IKD-ja: KUVENDI SHKELI TË DREJTAT E MBI 90 MIJË ZYRTARËVE, UA ZVOGËLOI PËRQINDJEN E SHITESËS MBI PËRVOJËN E PUNËS

F.8

KRYESUESI I BORDIT TË ZRRE-së TAKON PËRFAQËSUESIT E ODËS AMERIKANE DHE TË ATK-së, FLASIN PËR LIBERALIZIMIN E TREGUT TË ENERGJISË

F.8

SPORT



KOSOVA FITON DUELIN E PARË NDAJ ISLANDËS

F.6

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shagiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Turqia arreston 37 njerëz për shkak të postimeve në internet për Imamoglun

ANKARA, 20 MARS - Autoritetet turke i kanë arrestuar 37 njerëz për shkak të postimeve “provokuese” në rrjetet sociale në lidhje me arrestimin e kryetarit të Stambollit, Ekrem Imamoglu, njoftoi qeveria turke të enjten.

Imamoglu, rivali kryesor politik i presidentit Recep Tayyip Erdogan, u arrestua të mërkurën nën akuzat për korrupsion dhe mbështetje të një grupi terrorist. Partia kryesore opozitare e ka cilësuar arrestimin e tij “të tentim për puç kundër presidentit tonë të ardhshëm”.

Mijëra njerëz dolën në rrugë dhe në komplekset universitare në qytete të ndryshme, përfshirë Stambollin dhe Ankaranë, për të protestuar me slogane kundër qeverisë, pavarësisht se autoritetet i

ndaluan protestat për katër ditë menjëherë pas arrestimit të Imamoglut.

Autoritetet turke identifikuan 261 llogari në mediet sociale, duke përfshirë 62 jashtë vendit, me “postime provokuese që nxisin krim dhe urrejtje” pas arrestimit të Imamoglut dhe 105 personave të tjerë dhe po vazhdojnë përpjekjet për të gjurmuar të dyshuarit e mbetur, tha ministri i Brendshëm i Turqisë, Ali Yerlikaya, në X.

Ministri shtoi se 18.6 milionë postime rreth Imamoglut u shpërndanë në X brenda 24 orëve nga ndalimi i tij.

Imamoglu, 54 vjeç, prin para Erdoganit në disa prej sondazheve në Turqi.

Përveç ndalimit të protestave, autoritetet mbyllën disa rrugë dhe kufizuan qasjen në disa



rrjete sociale. “Ata e arrestuan me nxitim kryetarin e bashkisë sonë, të cilin e zgjodhëm me votat tona”, tha Ali Izar, një mbështetës i opozitës, derisa po

shkonte në punë në qendër të Stambollit. “Nuk mendoj se kjo është praktikë demokratike dhe e dënoj atë”, tha ai.

Turqia, gjithashtu, sekuestroi

një kompani ndërtimi të bashkëpronësuar nga Imamoglu, tha zyra e Prokurorisë së Përgjithshme të Stambollit.

Autoritetet e konfiskuan edhe një kompani në pronësi të Imamoglut, njoftoi zyra e Kryeprokurorit Publik të Stambollit.

Prokuroria tha se kontrolli mbi kompaninë “Imamoglu Construction, Trade and Industry” u mor nga gjykata, bazuar në raportet e hetimeve për krime financiare.

Shumica e 105 personave të arrestuar së bashku me Imamoglun janë pjesë e stafit të bashkisë së Stambollit. “Populli do ta japë përgjigjen e tij përsëri”, tha një tjetër mbështetës i Imamoglut, Yusuf Demirci, 34 vjeç, në Stamboll.

Pllenković: BE-ja duhet t’i kushtojë më shumë vëmendje mungesës së stabilitetit në Ballkan

ZAGREB, 20 MARS - Liderët e Bashkimit Evropian (BE) duhet t’i kushtojnë më shumë vëmendje mungesës së stabilitetit në Ballkanin Perëndimor, posaçërisht në Bosnjë-Hercegovinë dhe Serbi, tha të enjten kryeministri i Kroacisë, Andrej Pllenković.

“Duhet ta vëzhgojmë gjendjen në Evropën juglindore, posaçërisht stabilitetin e Bosnjë-Hercegovinës dhe situatën në Serbi”, tha Pllenković para samitit të BE-së në Bruksel. “Ka kaq shumë ngjarje globale për momentin. Është koha që një pjesë e asaj vëmendjeje të fokusohet edhe në një rajon që është treguar shumë i ndezshëm gjatë 35 vjetëve të fundit”, deklaroi Andrej Pllenković për gazetarë.

Ai po i referohej krizës më të



rëndë politike në Bosnjë që nga përfundimi i luftës së saj 1992-’95, e shkaktuar nga lëvizjet separatiste të Republikës Sërpska, pasi lideri i saj, Millorad

Dodik, u dënua me një vit burg për shpërfilljen e vendimeve të përfaqësuesit të lartë ndërkombëtar.

Pllenković, gjithashtu, iu referua

edhe protestave disamujore kundër Qeverisë në Serbi, pas vdekjes së 15 njerëzve nga shembja e një strehe prej betoni në stacionin hekurudhor në Novi Sad në nëntor.

Pllenković i komentoi edhe deklaratat e presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, i cili të mërkurën tha se Kroacia dhe Shqipëria e kanë hapur “një garë armësh” duke nënshkruar memorandum për bashkëpunim në mbrojtje me Kosovën.

Sipas transmetuesit publik kroat, HRT, kryeministri kroat deklaroi në Bruksel se e kupton që në Serbi po përpiqen të kërkojnë probleme diku tjetër, por se ato nuk gjenden në memorandumin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, e nënshkruar rishtazi

mes Kroacisë, Kosovës dhe Shqipërisë. “Ky është një memorandum për bashkëpunim të përbashkët, nuk ka asnjë karakter armiqësor, kështu që e kuptoj që tani po kërkojnë probleme diku tjetër, por në këtë tekst ato nuk ekzistojnë”, tha Pllenković duke iu përgjigjur pyetjes për deklaratën e presidentit serb Aleksandar Vuçiq.

Lideri serb tha se memorandum i përbën shkelje të së ashtuquajturës marrëveshje nënrajonale për kontrollin e armatimit nga viti 1996 dhe se është “pothuajse i sigurt” që për këtë nuk është njoftuar NATO-ja.

Pllenković nguli këmbë se ky memorandum ndihmon përpjekjet e Kosovës dhe Shqipërisë në reformat e tyre dhe në shkëmbimin e përvojave.

U jepet lamtumira 59 viktimave të Koçanit

KOÇAN, 20 MARS - 59 viktimat e tragjedisë në Koçan u dërguan në banesën e fundit të enjten. Të paktën 59 njerëz vdiqën dhe 155 të tjerë u lënduan si pasojë e shpërthimit të zjarrit në një klub nate në Koçan në orët e para të 16 marsit.

Trupat e të vdekurve do të varrosen në pjesë të ndryshme të vendit, përfshirë Koçanin, Shtipin, Shkupin, Strumicën dhe fshatin Obleshevë.

Qeveria e Maqedonisë së Veriut urdhëroi institucionet shtetërore dhe këshilloi qeveritë lokale dhe punëdhënësit e sektorit privat t’i lirojnë të gjithë të punësuarit në territorin e Koçanit nga detyrat e punës për ditën e varrimit.

Kreu i Kishës Ortodokse

Maqedonase - Kryepeshkopata e Ohrit (KMK-OA), kryepeshkopi Stefan, ka bërë thirrje për unitet dhe lutje pas tragjedisë së tmerrshme në Koçan.

Qeveria maqedonase ka shpallur shtatë ditë zie për këtë tragjedi, ku shumica e viktimave ishin të rinj.

Autoritetet kanë premtuar hetim të shpejtë dhe të plotë, si dhe kanë arrestuar 23 dyshuar deri tani, 11 prej të cilëve ndodhen në paraburgim.

Autoritetet kanë zbuluar se klubi operonte në mënyrë të paligjshme, nuk kishte dokumente të vlefshme për punë, nuk kishte leje për përdorimin e piroteknikës dhe nuk kishte nënshkruar kontratë me grupin muzikor.



Ndër shkeljet e konstatuara është edhe lejimi i të miturve në klub.

Rreth 500 njerëz ndodheshin në

klubin e natës kur zjarri shpërtheu teksa bendi ADN po performonte.

Ndërkohë, të gjithë të lënduarit

në zjarrin e Koçanit po mjekohen në vend dhe në qendrat e specializuara mjekësore jashtë vendit.

A PO FORMOHET NJË ALEANCË USHTARAKE NË BALLKAN?

Një deklaratë për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes, në mes të Kosovës, Shqipërisë dhe Kroacisë, e zemëroi Serbinë, e cila e konsideroi atë kërcënim ndaj saj. Çfarë thotë NATO-ja për nismën e re ballkanike, dhe si e shohin atë njohës të sigurisë në Prishtinë dhe në Beograd?



PRISHTINË, 20 MARS - Kosova dhe dy shtete të rajonit të Ballkanit Perëndimor që janë pjesë e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), Shqipëria dhe Kroacia, nënshkruan këtë javë një deklaratë për thellim të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. Pa dhënë hollësi konkrete, ministrat e Mbrojtjes të tri shteteve thanë se do ta rrisin ndërveprueshmërinë e ushtrive përmes edukimit, trajnimit dhe stërvitjeve të përbashkëta, si dhe do të angazhohen për luftimin e kërcënimeve hibride, por edhe do t'i koordinojnë politikat për integritet euroatlantike. Serbia e pa këtë si hap që “minon stabilitetin rajonal” dhe si kërcënim për “integritetin territorial” të saj, kurse Kosova tha se nisma s’duhet të shihet si kërcënim ndaj askujt, por duhet të pranohet edhe si mesazh se tri shtetet do të jenë të bashkuara përballë çfarëdo sfide apo kërcënimi. Njohës të sigurisë, në Prishtinë dhe në Beograd, nuk e shohin deklaratën si hap drejt formimit të një aleance formale të mbrojtjes, sikurse është ajo e NATO-s.

Çfarë i bashkon tri shtetet?

Për Ramadan Ilazin, udhëheqës i hulumtimeve në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), rëndësia e deklaratës qëndron te fakti se erdhi në kohën kur është rritur paparashikueshmëria e aleancave ekzistuese të sigurisë në botë. Ai e sheh nismën si hap drejt forcimit të alternativave ose aleancave strategjike, që Kosova të avancojë në aspektin e mbrojtjes, pasi ende nuk ka një rrugë të qartë të anëtarësimit në NATO. “Unë nuk jam optimist që kjo aleancë shënon fillimin e krijimit të një blloku formal të mbrojtjes, por më shumë të një grupi të ri të shteteve në Evropë, të cilat e ndajnë të njëjtin shqetësim ose të njëjtin lexim të situatës së sigurisë në Evropën Juglindore”, tha Ilazi për “Radion Evropa e Lirë”. Ilazi beson se misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, KFOR, dhe vetë aleanca, do të jenë ombrellë e këtyre bashkëpunimeve, pasi nuk mendon se Shqipëria dhe Kroacia do të vepronin në

kundërshtim me interesat e NATO-s në rajon. Një zyrtar i NATO-s i tha “Radios Evropa e Lirë” se Shqipëria dhe Kroacia janë kontribuuese të kamotshme për stabilitet rajonal, edhe përmes kornizës të KFOR-it. I pyetur për nismën e re, zyrtari tha se aleanca “është në dijeni”, por se u takon palëve nënshkruese të deklaratës të thonë më shumë. Pavarësisht se nuk e ka formën e një marrëveshjeje ndërkombëtare, nisma, me vullnet politik të palëve, mund të çojë “në veprime të buta politike”, sipas ekspertit për çështje të sigurisë në Qendrën e Beogradit për Politika të Sigurisë, Vuk Vuksanoviq. Ai tha për “Radion Evropa e Lirë” se bashkëpunimi ballkanik pjesërisht është nxitur mes paralajmërimeve për një reduktim të mundshëm të “angazhimit të Shteteve të Bashkuara në NATO, nëse evropianët nuk investojnë më shumë për mbrojtjen e tyre”. Sipas Vuksanoviqit, në një mjedis ku NATO-ja nuk largohet, por “ku ajo dobësohet, mund të ndodhë që shtetet e caktuara të formojnë grupime joformale për të bashkëpunuar”. Kosova, Shqipëria dhe Kroacia

paralajmëruan se nisma mund të zgjerohet me anëtarë të rinj, ndonëse s’kanë përmendur emra shtetesh. Megjithatë, Serbia aludoi se një nga këto shtete mund të jetë Bullgaria. Edhe nëse i shtohen vende të tjera, Ilazi nuk mendon që ky grup po lëviz drejt krijimit të një aleance ushtarake që mishëron parimet e NATO-s, sikurse mbrojtja kolektive.

Pse Serbia po e kundërshton nismën?

Beogradi kërkoi shpjegim nga Tirana dhe nga Zagrebi lidhur me qëllimet e nismës, teksa tha se “nuk do të lejojë veprime të njëanshme që mund të rrezikojnë integritetin tonë territorial, sigurinë e qytetarëve dhe paqen në rajon”. Ministria e Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës u kundërpërgjigj, duke thënë se një sjellje e tillë e Serbisë paraqet një shkelje të re të Marrëveshjes së Brukselit, “e cila përcakton qartë se Serbia nuk do të pengojë marrëdhëniet ndërkombëtare të Kosovës”. Ndërkaq, Kroacia tha se ka kaluar koha kur Zagrebi i kërkonte leje Beogradit se si të

vepronte e më kë të bashkëpunonte. Për Vuksanoviqin, Serbia me më shumë gjasa e sheh këtë nismë si “provokim politik nga ana e Zagrebit”. Sipas tij, pushteti në Beograd mund ta përdorë këtë zhvillim për të zhvendosur vëmendjet nga situata politike në Serbi dhe protestat që po mbahen atje tash e disa muaj. Edhe Ilazi mendon se reagimi i ashpër i Serbisë është thjesht për shkak të përfshirjes së Kroacisë, e cila në vitet ’90 zhvilloi një luftë për pavarësi nga ish-Jugosllavia. Megjithatë, ai konsideron se bashkëpunimi trepalësh është nxitur nga mendimi i njëjtë se Rusia ushtron një ndikim dashakeqës në rajon, dhe se regjimet autokratike në rajon paraqesin kërcënim për stabilitetin e Ballkanit - akuza që janë bërë vazhdimisht edhe nga autoritetet kosovare. Përderisa mendon se Kosova do të përfitonte shumë nga përvojat e dy shteteve të NATO-s, por edhe nga trajnimet e ndryshme, Ilazi shpreh skepticizëm rreth zbatimit të nismës, duke kujtuar nivelin e ulët të zbatimit të marrëveshjeve të mëparshme mes Prishtinës dhe Tiranës.

PRESIDENTI I LETONISË NË PRISHTINË: MASAT E BE-së NDAJ KOSOVËS DUHET TË HIQEN, SA MË SHPEJT, AQ MË MIRË

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, sërish ka bërë thirrje për heqjen e masave ndëshkuese të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës, ndërsa homologu i saj nga Letonia, Edgars Rinkevics, ka thënë se shteti që udhëheq ai është në të njëjtën linjë. Ata i kanë bërë këto komente në një konferencë të përbashkët për medie të enjten në Prishtinë. “Diskutuam edhe për heqjen e masave ndaj BE-së. Qëndrimi i vendit tim është që BE-ja duhet t’i heqë ato masa kufizuese. Sa më shpejt që bëhet kjo, aq më mirë”, ka thënë Rinkevics

**EPOKA E RE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 20 MARS - Presidenti i Letonisë, Edgars Rinkevics, ka thënë të enjten në Prishtinë se Letonia është pro heqjes së masave kufizuese të BE-së ndaj Kosovës.

Rinkevics ka theksuar se e mbështetësin edhe normalizimin e plotë të marrëdhënieve në mes të Prishtinës dhe Beogradit. “Diskutuam edhe për heqjen e masave ndaj BE-së. Qëndrimi i vendit tim është që BE-ja duhet t’i heqë ato masa kufizuese. Sa më shpejt që bëhet kjo, aq më mirë. Gjithashtu, mbështesim normalizimin e plotë të marrëdhënieve në mes të Prishtinës dhe Beogradit, vazhdimin e dialogut sepse besojmë se kjo është mënyra më e mirë për ta përmirësuar stabilitetin dhe sigurinë në rajon në një afat më të gjatë”, ka

thënë Rinkevics. Ai ka theksuar se nuk mund të premtojë që statusi i vendit kandidat për BE mund t’i jepet Kosovës deri në fund të vitit, duke u shprehur se “nuk mund të flas në emër të të gjitha shteteve anëtare”.

Presidenti letonez këto komente i bëri në një konferencë për medie, pas takimit që pati me presidenten Vjosa Osmani në Prishtinë. Ai më tutje theksoi se janë të interesuar t’i forcojnë marrëdhëniet politike dhe ekonomike. “Letonia e mbështet plotësisht integritimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare. Keni mbështetjen tonë të plotë për anëtarësim në Këshillin e Evropës. Gjithashtu mbështetje të plotë keni nga Letonia edhe për procesin e integritimit evropian”, ka thënë Rinkevics.

Rinkevics në fund ka falënderuar Kosovën për mbështetjen e saj ndaj Ukrainës, dhe i ka bërë ftesë

publike presidentes Osmani ta vizitojë Letoninë. “Jeni e mirëseardhur që ta vizitoni Letoninë”, ka thënë presidenti letonez.

Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka falënderuar shtetin e tij që mbështet Kosovën në shumë fusha, gjersa kërkoi nga Bashkimi Evropian t’i largojë masat e padrejta ndaj Kosovës. Ajo ka thënë se Letonia është një partnere e fuqishme e Kosovës dhe ka përkrahur anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare, duke kontribuar kështu në fuqizimin e shtetit të Kosovës. “Letonia e kupton më së miri pozicionin e Kosovës pasi dy

vendet tona kanë një të kaluar të dhimbshme dhe shumë të vështirë dhe kufizohen me shtete agresore”, është shprehur Osmani.

E para e shtetit të Kosovës ka thënë se qytetarët e Kosovës kanë nivelin më të lartë të besueshmërisë karshi BE-së. “Prandaj, është edhe koha që me prioritet të largohen masat e padrejta që Bashkimi Evropian i ka ende në fuqi ndaj Kosovës dhe sa më shpejt që të gjendet metoda, të gjendet mënyra dhe rruga përpara për statusin e vendit kandidat të Republikës sonë”, ka deklaruar ajo.

Osmani tutje tha se sikur Letonia

edhe Kosova janë të përkushtuara për vlera euro-atlantike, fqinjësi të mirë, duke ruajtur sovranitetin dhe integritetin territorial. Ajo falënderoi presidentin Rinkevics për zgjatjen e mandatit deri në dhjetor 2025 të 140 ushtarëve letonezë në Kosovë që janë në kuadër të KFOR-it.

Osmani ka treguar se kanë biseduar edhe për zgjerimin në fushën e mbrojtjes. “Si rezultat i sfidave të reja të sigurisë diskutuam edhe për modalitetet që Kosova të kontribuojë në mënyrë aktive në arritjen e objektivave të përbashkëta në fushën e sigurisë”, është shprehur presidentja Osmani.

POLICIA THOTË SE KA PËRMBUSHUR ME SUKSES MISIONIN PËR RUAJTJEN E RENDIT E TË QETËSISË PUBLIKE NË VEND

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 MARS - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, së bashku me stafin e lartë menaxhues, realizuan një takim zyrtar me drejtorët e drejtorive rajonale, i cili kishte për qëllim prezantimin dhe analizimin e raportit vjetor, planin e punës, objektivat specifike si dhe aktivitetet policore të cilat burojnë nga plani zhvillimor strategjik i PK-së, përfshirë strategjinë e Policimit të Udhëhequr nga Inteligjenca dhe Policisë në Bashkësi.

Analizat dhe krahasimet e raportit vjetor të vitit 2024 treguan se Policia e Kosovës ka përmbyshur me sukses misionin dhe vizionin e saj, të menaxhojë ruajtjen e rendit e qetësisë publike, rendit kushtetues, sigurisë në trafik, kontrollin dhe mbikëqyrjen kufitare, si dhe ka arritur rezultate pozitive në ulje të numrit të



përgjithshëm të veprave, kundërvajtjeve dhe rasteve të natyrave të tjera, përfshirë uljen e aksidenteve të përgjithshme e

atyre me pasoja fatale në nivel vendi.

Pas analizimit të raportit vjetor, takimi ka vazhduar me

prezantimin e planit të punës, objektivat strategjike policore dhe prioritetet e PK-së, ku drejtori Hoxha nga të pranishmit kërkoi të

zbatohen në përpikëri planet dhe synimet e planifikuara, e të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e përgjithshme, rritjen e bashkëpunimit dhe qasjes më proaktive me komunitetin, parandalimin, hetimin dhe zbulimin e veprimtarive kriminale, si dhe rritjen e performancës, integritetit, mbikëqyrjes më efikase dhe disiplinës në punë.

Ndër të tjera, drejtori Hoxha theksoi se përmes zbatimit të ligjit, menaxhimit sa më efikas të burimeve njerëzore dhe atyre logjistike, mbikëqyrjes së performancës së zyrtarëve policorë, mund të arrihen rezultate edhe më pozitive në shumë sfera policore.

Takimi rezultoi me zotimin për angazhime shtesë nga të gjithë të pranishmit, me qëllim të përmbyshjes së detyrave dhe obligimeve policore, të cilat janë në interes të qytetarëve dhe të vendit.

MUNGESA TË NACL E GLUKOZËS, SHOQATA E DISTRIBUTORËVE: ÇMIMET E CAKTUARA NGA MSH PO KRIJOJNË PROBLEME NË FURNIZIM TË BARNATOREVE

PRISHTINË, 20 MARS - Nivelizimi i çmimit të barnave nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, ndonëse është destinuar të sjellë lehtësira për qytetarët dhe xhepin e tyre, ka prodhuar efekt negativ sa i përket furnizimit të barnatoreve me medikamente. Së fundmi barnaret në sektorin privat janë duke u përballur me mungesë të përfuzioneve si NaCl, glukozë e të tjera, pikërisht për shkak të vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë për nivelizimin e çmimit të barnave. Mungesën e tyre produkteve që janë jetike për shëndetin e qytetarëve e ka konfirmuar për Telegrafin edhe Shoqata e Distributorëve të Produkteve Farmaceutike dhe Medicinale të Kosovës. Sipas shoqatës, arsyeja kryesore për mungesën e këtyre produkteve është çmimi i miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, i cili, sipas saj, është shumë i ulët dhe nuk mbulon kostot reale të furnizuesve. “Po, kemi informata për mungesë në sektorin privat të të gjitha përfuzioneve si NaCl, glukozë dhe të tjera, të cilat, për shkak të çmimeve tejet të ulëta të miratuara (nën çmimin furnizues) nga ana e komisionit për deklarimin e çmimeve pranë MSh, furnitorëve u është pamundësuar furnizimi permanent dhe importi i këtyre produkteve”, ka njoftuar Shoqata. Po ashtu, ajo ka treguar se Ministria e Shëndetësisë ka nxjerrë një vendim të ri i cili mund të ndihmojë në përmirësimin e situatës. “Në ndërkohë, MSh ka nxjerrë një vendim të ri me të cilin distributorët farmaceutikë ose BAM (Bartësit e Autorizimit të

Marketingut ose përfaqësuesit e tyre) mund të aplikojnë me kërkesë ndryshim/përmirësim të çmimit dhe ne besojmë që kjo do të na ndihmojë shumë në vazhdimësi të furnizimit dhe normalizim të tregut në përgjithësi me produkte farmaceutike”, thuhet në përgjigjen e ShDPFMK-së. Shoqata ka shpjeguar se çmimi i miratuar nga Ministria e Shëndetësisë nuk ka marrë parasysh disa faktorë të rëndësishëm të kostos. “Faktori kryesor është çmimi i caktuar ku në shumicën e rasteve, çmimi i miratuar nga MSh nuk është bërë sipas Nenit 8 të Ligjit sipas çmimeve mesatare të vendeve referente, por sipas çmimit CIP, duke miratuar kështu çmime nën çmimet furnizuese”, ka theksuar Shoqata, duke shtuar se kostot e tjera, si transporti, leja e importit dhe operacionet e tjera, nuk janë përfshirë në çmimet e miratuara. Një tjetër shqetësim që është shprehur nga barnaret, është fakti që disa depo furnizuese po ofrojnë barna me çmime të vjetra, të cilat nuk përputhen me listën e çmimeve të reja të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë. Shoqata e Distributorëve të Produkteve Farmaceutike dhe Medicinale të Kosovës ka theksuar se një nga problemet është stoku i krijuar nga depot farmaceutike, i cili është në çmime të vjetra dhe pa afate të qarta për zbrazjen e tij. “Problem tjetër thelbësor janë stoqet e krijuara te depot farmaceutike për të cilat MSh nuk ka dhënë ndonjë afat dhe alternativë për zbrazjen e stoqeve me çmime të vjetra. Prandaj barnarët me të



drejtë shqetësohen për furnizimet e reja, por edhe për stoqet e tyre të furnizimeve të mëhershme, pasi që në rast se stoku i blerë më herët nga barnatorja (për çka janë paguar taksat ndaj shtetit në bazë të çmimeve të blera/paguara) sikur të shitej në çmimin e blerë (sipas çmimeve të miratuara) do të kishte humbje të konsiderueshme financiare”, ka deklaruar Shoqata. ShDPFMK ka kërkuar një periudhë kohore për zbrazjen e këtyre stoqeve dhe fillimin e importimit të produkteve me çmime të reja, duke kërkuar që ky proces të mundësohet në një afat prej 3-6 muajsh. “Ne si Shoqatë kemi kërkuar disa herë përmes kërkesave të shkruara dhe reagimeve publike nga MSh

që të mundësojë një afat prej 3-6 muaj për zbrazje të stoqeve nga depot dhe barnaret, kurse me zbrazjen e stoqeve të vjetra të fillohet importi i produkteve me çmime të reja (aty ku është e mundur dhe e leverdishme)”, thuhet në përgjigjen e ShDPFMK-së për Telegrafin. Shoqata e Distributorëve të Produkteve Farmaceutike dhe Medicinale të Kosovës ka shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar me Ministrinë e Shëndetësisë dhe palët e tjera të interesuara për të siguruar furnizimin e vazhdueshëm me barna esenciale dhe për të ndaluar praktikën e shitjes me çmime të vjetra. “Bazuar në ligjin aktual, ne në Shoqatë në çdo kohë jemi të gatshëm të ulemi dhe ta japim

maksimumin për gjetjen e një zgjidhje të pranueshme për të gjitha palët, si distributorët farmaceutikë, Ministria e Shëndetësisë dhe pacienti, pra duhet të jemi të kujdesshëm për gjetjen e formulës për një qëndrueshmëri financiare të distributorëve farmaceutikë dhe furnizim të pandërprerë me barna”, kanë përfunduar ata. Telegrafi ka dërguar pyetje edhe në Ministrinë e Shëndetësisë rreth situatës së krijuar, por të njëjtët deri në publikimin e këtij artikulli nuk janë përgjigjur. Kujtojmë se Ligji për Çmimin e Produkteve Medicinale nr. 08/L-220 ka hyrë në fuqi në gusht të vitit 2023, ndërkaq Lista Zyrtare e Çmimeve, sipas vendimit nr. 05-10072, datë 23.12.2024, ka hyrë në fuqi nga data 01.02.2025.

PROKURORIA KËRKON PARABURGIM PËR TETË NGA TË ARRESTUARIT NË AKSIONIN KUNDËR KONTRABANDËS SË ARMËVE

PRISHTINË, 20 MARS - Prokuroria Themelore në Mitrovicë tha se i ka kërkuar gjykatës ta caktojë masën e paraburgimit për tetë persona të arrestuar një ditë më parë, nën dyshime për kontrabandë të armëve. Më 19 mars autoritetet e sigurisë zhvilluan një aksion në 21 lokacione në Mitrovicën e Jugut, Mitrovicën e Veriut, Vushtrri, Skenderaj dhe Leposaviq, ku arrestuan 16 persona dhe konfiskuan armë e municione. Seanca lidhur me kërkesën e caktimit të masës së paraburgimit ka nisur në orën 13:00 në Gjykatën Themelore të Mitrovicës. Prokuroria tha se për të dyshuarit B. H., I. P. dhe O. B. kërkon paraburgim pasi dyshohet se kanë kryer veprat penale “detyrim” dhe “import, eksport, furnizim, transportim, prodhim,



këmbim, ndërmjetësim ose shitje e paautorizuar e armëve apo material plasëse”. Ndërkaq A. S., T. R., A. B., Sh. S.

dhe N. R., po ashtu dyshohen për veprën që ka të bëjë me importin, eksportin, prodhimin e shitjen e paautorizuar të

armëve. Policia deklaroi se aksioni i 19 marsit u krye pas hetimeve disamujore.

Zëvendësdrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, më 19 mars i tha Radios Evropa e Lirë se në mesin e të arrestuarve është dhe një zyrtar policor, i cili është pezulluar nga puna. “Polici është pezulluar përkohësisht gjatë arrestimit, deri në përfundimin e hetimeve. Nëse është i pafajshëm, do të kthehet në punë”, deklaroi ai. REL-i mësoi nga burimet e saj se polici i arrestuar është nga radhët e komunitetit serb. Autoritetet e sigurisë nuk kanë dhënë hollësi se nga cilat vende apo në cilat shtete mund të kenë importuar dhe eksportuar të dyshuarit. Edhe më herët Policia e Kosovës ka gjetur dhe konfiskuar armatim kohë pas kohe, veçanërisht në pjesën veriore të shtetit, të banuar me shumicë serbe.

ShBA-ja, partnere strategjike për ecjen e Kosovës drejt anëtarësimit në NATO

PRISHTINË, 20 MARS - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka takuar të enjten gjeneralin amerikan Chris A. McKinney, ndërsa ka theksuar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë elementë të rëndësishëm për zhvillimin e mëtutjeshëm të Kosovës drejt anëtarësimit në NATO, por dhe për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor. “Shtetet e Bashkuara të Amerikës si shtet mik i yni dhe partner strategjik

janë element i rëndësishëm për zhvillimin e mëtutjeshëm të Kosovës drejt anëtarësimit në NATO, por dhe ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor. Me gjeneral brigade Chris A. McKinney, Zëvendësdrejtor i Partneritetit, Bashkëpunimit të Sigurisë dhe Armëve të Shkatërrimit në Masë të Komandës Evropiane të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USEUCOM) që sot kisha nderin ta pres në takim së

bashku me të ngarkuarën me punë në Ambasadën e ShBA në Kosovë, Annu Prattipati, diskutuam për gjendjen e sigurisë në vend, ndërsa e njoftova për të arriturat e deritanishme të FSK-së, si dhe fokusin e zhvillimit për vitet në vijim, rritjen e kapaciteteve ushtarake përmes blerjeve shtet më shtet, ku partner strategjik shohim ShBA-të, dhe veçanërisht zhvillimin e industrisë së mbrojtjes”, ka



shkruar Maqedonci në “Facebook”. Ai ka thënë se duke vlerësuar lart bashkëpunimin e

deritanishëm në mes të FSK-së dhe Komandës Evropiane të Ushtrisë Amerikane, gjeneralit Kinney i ka shprehur falënderimin për mbështetjen e vazhdueshme si në fushën e trajnimeve, po ashtu në projekte të ndryshme infrastrukturore, ndërsa të dy u dakorduan për shtim të bashkëpunimit dhe konkretizim të projekteve, të cilat kanë për qëllim zhvillimin profesional dhe taktik të FSK-së.

FORUMI I STUDIMEVE TË EVROPËS JUGLINDORE: ROLI I UNIVERSITETEVE NË NJË BOTË QË PO NDRYSHON SHPEJT

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 20 MARS - Në fjalimet hapëse të Forumit të Dytë të Studimeve të Evropës Juglindore që po zhvillohet në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës, u kërkuar gjetja e vendit dhe rolit të universiteteve, kërkimeve shkencore dhe akademisë në kohët moderne të inteligjencës artificiale dhe një bote të trazuar nga luftërat. Në forumin që do të zgjasë tri ditë, të udhëhequr nga profesori Ger Duijzings, drejtuesi i Projektit “Seeffield”, që ka për qëllim fuqizimin e studimeve të Evropës Juglindore në Regensburg të Gjermanisë, po marrin pjesë profesorë e hulumtues shkencorë nga Universiteti i Prishtinës, universitetet e rajonit dhe Evropës



Juglindore. Duke iu drejtuar të pranishmëve, rektori Arben Hajrullahu tha se po i pëlqen kjo hapësirë diskutimi. “Jam i bindur se do të lindin shumë ide dhe ndoshta dikush do t’i përmbledhë ato për t’i vënë në jetë”, deklaroi i pari i Universitetit të

Prishtinës. Ai foli edhe për rolin e universiteteve në kohën e ndryshimeve të shpejta teknologjike. “Inteligjenca artificiale me siguri nuk do t’i lërë universitetet ashtu siç kanë qenë, por jam mjaft i bindur se thelbi i universitetit është i njëjtë për shekuj: t’i

mësojë njerëzit të mendojnë, jo thjesht t’u thonë studentëve çfarë të bëjnë”, tha rektori Hajrullahu. Për rektorin Hajrullahu, forume si ky që po organizohet në Universitetin e Prishtinës, ndihmojnë njerëzit për t’i shkatërruar paragjykimet dhe për të pasur “më shumë njerëz në rajon, në Evropën Perëndimore dhe në botë që mendojnë bazuar në prova shkencore”. Në Forumin e Studimeve të Evropës Juglindore foli edhe profesoresha e sociologjisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, Vjollca Krasniqi. Ajo tha se “qëllimi i Forumit është reflektimi mbi rolin e universitetit në kontekstin e Evropës Juglindore dhe më gjerë, përmes perspektivave krahasimtare institucionale, shoqërore, dhe

historike”. Profesoresha Krasniqi, po ashtu, theksoi se “universitetet kërkojnë modalitete për t’iu përgjigjur sfidave politike dhe shoqërore, krizave financiare dhe ndryshimeve demografike të ndikuara nga migrimi”. Sivjet edicioni i dytë i Forumit të Studimeve Evropiane do të fokusohet në tri blloqe tematike: angazhimin publik universitar në kohën e medie të reja, mësimin e gjuhëve: trashëgiminë, përfshirjen, mjetet e inteligjencës artificiale dhe trajektorët e karrierës për studiuesit e rinj të rajonit. Projekti “Seeffield”, që ka nisur para tre vjetësh dhe do të vazhdojë deri në vitin 2029, mes të tjerash, do t’i kushtojë rëndësi shumë të madhe studimit të gjuhës shqipe.

PROKURORIA E PEJËS KOORDINOHET ME INSTITUCIONET PËR SIGURINË NË SHKOLLA

PEJË, 20 MARS - Me ftesë dhe iniciativë të kryeprokurores së Prokurorisë Themelore në Pejë, Lumturije Vuçetaj, është mbajtur takim me drejtorët e drejtorive të arsimit në regionin e Pejës dhe përfaqësues të tjerë, ku ishin të pranishëm drejtorët e drejtorive të arsimit nga komuna e Pejës, e Deçanit, e Istogut, e Junikut, përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit, përfaqësues nga Policia e Kosovës, prokurorët koordinatorë të caktuar për rastet e veprave penale kundër drogës, integritetit seksual dhe dhunës në familje, ku u diskutua për një koordinim ndërinstitutional në

mes të Prokurorisë dhe aktorëve përgjegjës për mbarrëvajtjen dhe sigurinë e një procesi arsimor, për një ambient të qetë shkollor. Temë e diskutimit të këtij takimi ishte caktimi i shkollave për mbajtjen e ligjëratave në tri fusha: dhuna në familje, pasojat e përdorimit të substancave narkotike dhe mbrojtja e integritetit seksual. Gjatë këtij takimi u dhanë opinione të ndryshme, ku nga pjesëmarrësit u vlerësua si iniciativë e qëlluar, edhe pse më parë ka qenë, por kjo është zbatuar vetëm në komunën e Pejës, por jo edhe në komunat e



tjera të regionit, aty ku shtrihet edhe kompetenca lëndore dhe territoriale e Prokurorisë

Themelore në Pejë, gjë që u mirëprit nga përfaqësuesit e komunave të tjera.

Si rezultat i takimit janë nxjerrë disa konkluzione që në takimet e radhës të jenë të pranishëm edhe kryetari i Këshillit të Prindërve; caktimi i shkollave për mbajtjen e ligjëratave; mbikëqyrja e kamerave të vendosura në shkolla nga personat kompetentë dhe të autorizuar për mirëmbajtjen dhe funksionalizimin e tyre; mbikëqyrja e kopshteve shtetërore dhe atyre private nga Ministria e Arsimit dhe Inspektorët përkatës si dhe ligjëratë për posedimin e mjeteve të ftohta të cilat hyjnë në kuadër të armëve.

Policia ndalon kontrabandën në Novosellë, sekuestron mallra shtëpiake

PRISHTINË, 20 MARS - Policia e Kosovës, respektivisht njësitë policore kufitare të SPMK Muçivërcë - DRPK Lindje, gjatë operacionit policor të tyre në fshatin Novosellë, kanë vërejtur lëvizje të dyshimta të disa personave të cilët dyshohet se po kryenin veprime të paligjshme si dhe kanë identifikuar një mjet furgon të dyshuar me targa vendore.

Lidhur me rastin njësitë policore kanë reaguar në mënyrë të menjëhershme, me ç’rast është arritur të ndalohet furgoni i dyshuar, ku pas kontrollit të tij është konstatuar se drejtuesi i tij, mashkull kosovar, kishte të ngarkuar mallra të ndryshme të sjella nga Evropa, si: dhomë gjumi, orendi kuzhine, 1 televizor, 6 telefona mobilë, enë kuzhine,

pajisje të tjera shtëpiake me vlerë të konsiderueshme. Bazuar në dyshimet e arsyeshme, dyshohet se malli i gjetur është futur në territorin e Republikës së Kosovës përmes rrugëve ilegale, me qëllim përfitimi personal ose në dobi të një personi tjetër. Me urdhër të prokurorit kujdestar, rasti është cilësuar si ‘kundërvajtje doganore’, ndërsa malli i

sekuestruar i është dorëzuar Doganës për vlerësim dhe procedim të mëtejshëm. Furgoni është sekuestruar nga Policia e Kosovës, pasi drejtuesi i tij po e drejtonte automjetin gjatë periudhës së ndalimit të patentëshoferit. Policia e Kosovës do të vazhdojë të mbetet e përkushtuar në luftën kundër kontrabandës dhe veprimeve



të tjera të paligjshme, duke garantuar rendin dhe sigurinë në kufijtë shtetërorë.

PZAP-i refuzon katër ankesat e subjekteve politike për rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve

PRISHTINË, 20 MARS - Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) i ka refuzuar katër ankesa të subjekteve politike në Kosovë lidhur me rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) e ka publikuar rezultatin përfundimtar më 15 mars dhe me Ligjin e ri për Zgjedhjet, subjektet politike kanë pasur mundësi që të ankohen brenda 48 orëve në rast se kanë besuar se u është shkelur ndonjë e drejtë. Lëvizja Vetëvendosje (LV), parti në pushtet dhe fituese e zgjedhjeve të 9 shkurtit, i ka dorëzuar dy ankesa, Partia Demokratike e Kosovës një, e koalicioni mes Partisë Demokratike të Ashkalinjve të Kosovës dhe Lëvizjes për Bashkëveprim (PDAK-LPB) një. Në ankesat e refuzuara të LV-së është kërkuar të anulohen rezultatet e votimit me postë për Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) dhe kandidatët e saj, dhe që të bëhet rinumërimi i votave në disa qendra të votimit në Skenderaj për shkak të dyshimeve për manipulime me vota. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e ka mirëpritur vendimin e PZAP-it, duke thënë se “përpjekjet e Lëvizjes Vetëvendosje për të manipuluar dhe delegjitimuar procesin zgjedhor ishin të pabazuara dhe shpërfaqin mosgatishmërinë e tyre për ta pranuar vullnetin e mërgatës sonë”. “Lidhja Demokratike e Kosovës nuk do të tolerojë që

Vetëvendosje të vazhdojë të përdorë shpifjet dhe manipulimet për të përmbysur vullnetin e qytetarëve dhe për të krijuar një realitet të rremë zgjedhor”, ka thënë kjo parti përmes një postimi në Facebook. Në ankesën e refuzuar të Partisë Demokratike të Kosovës është kërkuar rishikimi i vendimit të PZAP-it për shqiptimin e një gjobe prej 4 000 eurosh për këtë parti. Në ankesën e koalicionit mes Partisë Demokratike të Ashkalinjve të Kosovës dhe Lëvizjes për Bashkëveprim (PDAK-LPB) është kërkuar që të anulohen 211 votat e partisë politike Partia e Ashkalinjve për Integrim (PAI), të dërguara me postë dhe të rinumërohen votat, më pas që të anulohen disa vota në komunat që nuk kanë fare banorë të komunitet ashkalinj, të anulohen rezultatet e votave në disa shkolla dhe që të urdhërohet KQZ-ja ta përsërisë numërimin e votave të diasporës. Sipas të dhënave përfundimtare të KQZ-së, Lëvizja Vetëvendosje (LV) prin me mbi 390 000 vota apo 42.30 për qind. E dyta ka dalë Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me mbi 190 000 vota, apo 20.95 për qind, pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me mbi 170 000 mijë vota, apo 18.27 për qind. Në vendin e katërt është koalicioni mes Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nismës Social-demokrate me mbi 66 000 vota apo 7.06 për qind. Lista Serbe - partia më e madhe



e serbëve në Kosovë - ka siguruar mbi 39 000 vota apo 4.26 për qind. Me këto përqindje, LV-ja i ka siguruar 48 ulëse në Kuvendin e Kosovës, PDK-ja, 24 sosh, LDK, 20 vende, Lista Serbe nëntë vende dhe koalicioni AAK-Nisma, tetë vende. Të drejtë vote në këtë proces zgjedhor kanë pasur mbi 2 milionë shtetas të Kosovës, ndërsa pjesëmarrja ka qenë 46.54 për qind.

Çfarë ndodh tash?

Brenda 30 ditëve të certifikimit të rezultateve nga KQZ-ja, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, duhet ta thërrasë mbledhjen konstituive të

Kuvendit të Kosovës. Kjo mbledhje konsiderohet e mbyllur vetëm pasi të jenë zgjedhur kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit. Kryetari i Kuvendit do t'i takojë Lëvizjes Vetëvendosje (LV), e cila ka fituar më së shumti vota, por nëse kjo parti nuk e propozon dikë për kryetar, procesi do të ngrijë në vend. Nëse kryetari i Kuvendit zgjidhet, atëherë nisin tiktaket e orës për afatet e tjera. Presidentja e vendit obligohet ta nominojë partinë fituese të zgjedhjeve si mandatare për formimin e qeverisë. Ndonëse as këtu nuk ekziston një afat i saktë, vendimet në fuqi përcaktojnë që procesi duhet të zhvillohet “sa më parë

që të jetë e mundur”. Kabineti duhet t'i sigurojë votat e 61 deputetëve brenda këtij afati, por nëse kjo nuk ndodh, presidentja është e obliguar që brenda 10 ditëve t'i ftojë në konsultim edhe një herë partitë politike, dhe të vendosë, sipas diskrecionit të saj, për mandataren e re, nëse ajo ia dëshmon se i ka numrat për ta formuar qeverinë. Edhe mandatarja e ardhshme duhet t'i ketë 15 ditë kohë që t'ia paraqesë Kuvendit përbërjen e kabinetit qeveritar. E nëse qeveria nuk formohet as pas 40 ditësh, presidentja duhet të shpallë dekretin për zgjedhjet e reja, që duhet të mbahen dyzet ditë prej shpalljes së vendimit.

Kosova në mesin e vendeve më të lumtura në botë, në rajon i prin listës

PRISHTINË, 20 MARS - Raporti Botëror i Lumturisë i Rrjetit për Zhvillim të Qëndrueshëm të OKB-së sërish ka vënë në pah vendet të cilat janë më të lumtura dhe sërish shtet nordike i prijnë listës. Në raportin e publikuar bëhet me dije se shteti finlandez i prin listës, si vendi më i lumtur në botë. Pas Finlandës vijnë shtet e tjera nordike, Danimarka në vendin e dytë, Islanda në të tretin, Suedia në të katërtin dhe Holanda në të pestin. Më pas vijnë Kosta Rika, Norvegjia, Izraeli, Luksemburgu etj. Në mesin e shteteve Ballkanike, qytetarët e Kosovës janë më të lumturit. Kosova ndodhet në vendin e 29 në listë. Ndërsa pas Kosovës vjen Serbia në vendin e 31, Bosnjë-Hercegovina në vendin e 56-të, Mali i Zi në vendin e 71, Maqedonia e Veriut në vendin e 86-të si dhe Shqipëria në



vendin e 89. Në raport thuhet se këto “vlerësime të jetës” e vënë

fokusin në kënaqësinë e njerëzve me jetën. Në përmbledhjen ekzekutive

thuhet se fokusi në këtë raport ka qenë ndikimi i kujdesit nga personat e tjerë dhe ‘përhapja’

e lumturisë. “Ka shumë mënyra në të cilat ne kujdesemi dhe ndajmë me njëri-tjetrin. Ndoshta më universalja shembull është te ndarja e vakteve. Siç tregon kapitulli 3, të ngrënit i vetëm nuk është e mirë për mirëqenien tuaj. Njerëzit që hanë shpesh me të tjerët janë shumë më të lumtur dhe ky efekt qëndron edhe duke marrë parasysh madhësinë e familjes. Rritja e numrit të njerëzve që hanë vetëm është një arsye për rënien e mirëqenies në Shtetet e Bashkuara”, thuhet në këtë raport. Në korrik 2012 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara shpalli një rezolutë, sipas së cilës, Dita Ndërkombëtare e Lumturisë do të shënohet çdo vit më 20 mars. Objektivi i kësaj dite është të theksohet se lumturia dhe prosperiteti nuk janë vetëm dëshira personale, por edhe qëllime globale.

IKD-ja: Kuvendi shkeli të drejtat e mbi 90 mijë zyrtarëve, ua zvogëloi përqindjen e shtesës mbi përvojën e punës

PRISHTINË, 20 MARS - Kuvendi i Kosovës ka shkelur të drejtat e mbi 90 mijë zyrtarëve publikë, pasi ka shkurtuar përqindjen e shtesës mbi përvojën e punës për 15 vitet e para nga 0.5 për qind në 0.25 për qind. Kështu u tha në diskutimin publik të organizuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi. Aty u tha se nëse Kuvendi nuk vepron, zyrtarët publikë e kanë të drejtën që të kërkojnë kompensim në gjykatë. Përpos vërshimit të gjyqësorit me mbi 90 mijë lëndë, atëherë nga buxheti i shtetit duhen të paguhen edhe shpenzimet procedurale dhe kamata ligjore.

Gzim Shala, hulumtues i lartë në Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD), tha se nëse Kuvendi nuk vepron në drejtim të realizimit të së drejtës së zyrtarëve publikë për kompensim për përvojën e punës, ata kanë të drejtë të kërkojnë mbrojtje gjyqësore, duke kërkuar kompensimin e dëmit për shkak të mosveprimit të tyre. “Në këtë situatë tashmë zyrtarët publikë

kanë pësuar dëm. Nëse Kuvendi nuk vepron, zyrtarët publikë e kanë të drejtën që të kërkojnë mbrojtje gjyqësore, duke kërkuar përmes Gjykatës kompensimin e dëmit që iu është shkaktuar nga mosveprimi i Kuvendit”, tha Shala, teksa theksoi se kjo situatë mund të dërgojë deri në vërshimin e gjykatës me një numër lëndësh që mund të arrijë deri në 90 mijë raste të reja. “Nëse Kuvendi nuk vepron dhe zyrtarët publikë detyrohen t’i drejtohen gjykatës, potenciali në këtë rast është se gjykatat do të vershohen me rreth 90 mijë lëndë të reja, të cilat do të duhet t’i trajtojnë një për një”, shtoi Shala. Gjithashtu, sipas Shalës, përpos ndikimit që këto lëndë do të kenë në efikasitetin e punës së gjykatës, shpenzimet lidhur me procedurat gjyqësore do të bien në barrë të buxhetit të shtetit. “Në bazë të një kalkulimi të përgjithshëm, nga buxheti i Kosovës do të shpenzohen 35,770,502 euro për shpenzime procedurale, pa përfshirë kamatën ligjore dhe



shpenzimet e mundshme përmbartimore”, tha Shala. Përparim Gruda, deputet në ardhje i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), tha se është e paimagjinueshme që një vend demokratik nuk i respekton vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Sipas tij, Kuvendi nuk po zbaton aktgjykimin e Kushtetueses jo për shkak të mungesës së mundësive ligjore apo teknike, por sepse lideri nuk dëshiron ta bëjë një gjë të tillë. “Kjo është një situatë e papranueshme për një vend që pretendon të jetë demokratik

dhe të respektojë shtetin e së drejtës. Kam thënë edhe në një tryezë tjetër se kur trajtojmë problemet e moszbatimit të aktgjyimeve kushtetuese, nuk kemi të bëjmë thjesht me një bojkot nga ana e qeverisë, por me një qasje të strukturuar që e konsideron sundimin e ligjit si të negociueshëm”, tha Gruda. Armend Zemaj, deputet i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), tha se Kuvendi ka qenë pothuajse jofunksional që nga shkurti 2024 deri në ditën e zgjedhjeve, në këtë mënyrë nuk

është mundësuar inicimi i ndryshimeve të reja legjislative. Sipas tij, nëse vazhdohet kështu, dëmi do të jetë i madh, pasi administrata publike do të fillojë paditë e tyre, siç ka tashmë padi për kontrata kolektive ku vetëm kamatat e kanë ngarkuar tejmasë buxhetin e shtetit. “Kosova ka rrëshqitur në një situatë ku ka krijuar jostabilitet ligjor dhe kushtetues”, u shpreh Zemaj. Sipas tij, këtu është edhe qëllimi i Lëvizjes Vetëvendosje, duke thënë se nga ato që i kanë thënë në Kuvend ka rezultuar me shkelje edhe kushtetuese. “Nuk mundesh as si deputet as si opozitë të marrësh një iniciativë kur shumica parlamentare të bllokton. Lufta që Lëvizja Vetëvendosje i ka hapur Kushtetueses ka qenë luftë e hapur, sepse atakimi, edhe ne kemi qenë në pozitë dhe nuk na kanë pëlqyer vendimet e Gjykatës Kushtetuese, por as nuk është diskutuar zbatimi i saj. Na kanë pëlqyer edhe atëherë kur është ndërruar pushteti”, u shpreh Zemaj.

Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së takon përfaqësuesit e Odës Amerikane dhe të ATK-së, flasin për liberalizimin e tregut të energjisë

PRISHTINË, 20 MARS - Kryesuesi i Bordit të Zyrës Rregullatorit për Energji, Ymer Fejzullahu, mori pjesë në një bashkëbisedim me përfaqësuesit e Odës Amerikane të Kosovës. Ky takim kishte për qëllim diskutimin e kërkesave dhe sfidave të biznesit në sektorin e energjisë, me një fokus të veçantë procesin e liberalizimit të tregut të energjisë.

Gjatë këtij bashkëbisedimi kryesuesi i Bordit të ZRRE-së theksoi rëndësinë e liberalizimit të tregut të energjisë, duke e parë këtë proces si një hap të domosdoshëm për rritjen e konkurrencës dhe ofrimin e mundësive më të mira për



konsumatorët dhe bizneset. Ai theksoi se ky proces është jetik për zhvillimin afatgjatë të sektorit të energjisë në Kosovë dhe për krijimin e një ambienti

të favorshëm për investime. Kryesuesi i Bordit dëgjoi me vëmendje kërkesat dhe shqetësimet e përfaqësuesve të bizneseve të pranishëm në këtë

takim. Diskutimi ishte konstruktiv dhe u theksua rëndësia e bashkëpunimit të mëtejshëm ndërmjet ZRRE-së dhe sektorit privat, me qëllim sigurimin e një tregu energjetik të qëndrueshëm, të hapur dhe konkurrues.

Në kuadër të takimeve të vazhdueshme me institucionet shtetërore për liberalizimin e tregut të energjisë, kryesuesi i Bordit të ZRRE-së, Ymer Fejzullahu, ka mbajtur një takim edhe me drejtorin e Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj. Qëllimi kryesor i këtij takimi ishte bashkërendimi i veprimeve ndërmjet

institucioneve për t’i lehtësuar proceset e kërkesave ligjore që bizneset duhet të ndjekin për t’u futur në tregun e hapur të energjisë. Po ashtu, u diskutua mbi procedurat dhe dokumentet që konsumatorët duhet të sigurojnë për ta vazhduar furnizimin me energji në kuadër të shërbimit universal.

Ky takim është një hap i rëndësishëm në përpjekjet për të siguruar një kalim të qetë dhe të rregullt në tregun e hapur të energjisë, duke garantuar që të gjitha palët e përfshira të jenë të informuara dhe të përgatitura për ndryshimet që do të ndodhin.

Peci nënshkruan udhëzimin administrativ për pagesa direkte, më shumë se 30 mijë fermerë do të përfitojnë

PRISHTINË, 20 MARS - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, ka nënshkruar udhëzimin administrativ për implementimin e programit për pagesa direkte /subvencione 2025.

Peci ka thënë se kjo është një iniciativë e rëndësishme që synon zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të bujqësisë në Kosovë.

Ky program do të mundësojë mbështetje për mbi 30 000 fermerë, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e kushteve të punës për ata që operojnë në bujqësi. “Sot nënshkrova Udhëzimin Administrativ për implementimin e Programit për Pagesa Direkte / Subvencione 2025, program ky i cili do mundësojë zhvillimin

e mëtutjeshëm të sektorit të bujqësisë dhe ngritjes së kapaciteteve të mbi 30,000 fermerëve”, ka shkruar Peci në “Facebook”.

Pas nënshkrimit të udhëzimit do të fillojë periudha shtatëditore për publikimin e tij në Gazetën Zyrtare, pas së cilës do të jepen hollësi të tjera për hapjen e programit dhe mundësitë e aplikimit.



BASHKIMI EVROPIAN: TË BLEJMË MË SHUMË ARMË, POR JO NGA UASHINGTONI



Riarmatimi evropian shërben për të vazhduar luftën në Ukrainë, për të menaxhuar përçarjen me Shtetet e Bashkuara dhe për të konsoliduar industrinë evropiane të mbrojtjes.

Strategjia e Ursula von der Leyen është një lojë në rritje të vazhdueshme, e cila bëhet më e qartë në çdo hap që hidhet.

Dje ishte radha e Librit të Bardhë mbi Mbrojtjen, White Paper for European Defence Readiness 2030, ku Readiness do të thotë “gatishmëri”.

Pra, gati për vitin 2030, në një plan që synon t’i japë një shtysë të madhe industrisë evropiane të mbrojtjes, deri në pikën e integritimit të saj me atë ukrainase – e cila sot është kthyer në pikën kyçe të tregut të armëve.

Dokumenti u prezantua nga Komisioneri Evropian për Mbrojtjen, polaku Andrzej Murrer, dhe nga Përfaqësuesja e Lartë për Politikën e Jashtme, Kaja Kallas – përfaqësuesit më radikalë të strategjisë ushtarake kundër Rusisë.

Kubilius u përpoq gjithashtu t’i bënte një ofertë Italisë dhe qeverisë së saj, e cila është e lëkundur për planin e riarmatimit, duke lavdëruar

gjigantin e industrisë së mbrojtjes, Leonardo, si një aktor vendimtar në mbrojtje dhe duke u kujtuar skeptikëve se ky riarmatim “do të krijojë vende pune”.

Libri i Bardhë përshkruan një projekt për forcimin e industrisë evropiane të mbrojtjes, duke argumentuar se ky sektor ka qenë i “nënfinancuar” me kalimin e kohës dhe duke rikthyer gjithashtu “mitin” se shpenzimet ushtarake të Rusisë janë më të larta se ato të 27 vendeve të BE-së në kushte të barabarta të fuqisë blerëse.

Në fund të fundit, për të mbështetur idenë se “kemi nevojë për një bazë industriale të mbrojtjes më të fortë dhe më të qëndrueshme”, është e nevojshme të thuhet se sektori aktualisht është i dobët.

Plani i riarmatimit, tashmë i diskutuar në Komision dhe i miratuar nga Këshilli i BE-së, përbën shtyllën kryesore të Librit të Bardhë, me 800 miliardë euro burime financiare.

Këto fonde vijnë kryesisht nga zbutja e Paktit të Stabilitetit, gjë e cila do të lejojë një rritje të shpenzimeve të mbrojtjes me të paktën 1.5% të PBB-së duke filluar nga fundi i prillit. Brenda

kësaj pakete financiare përfshihet edhe instrumenti i ri financiar për mbështetjen e investimeve në mbrojtjen e shteteve anëtare, i quajtur Security and Action for Europe (SAFE), me një potencial prej 150 miliardë eurosh në formën e huave të garantuara nga buxheti evropian.

“Shtetet anëtare – thuhet në dokument – ftohen të risin me shpejtësi blerjet e përbashkëta në sektorin e mbrojtjes, në përputhje me objektivin e të paktën 40% të propozuar nga Strategjia Evropiane për Industrinë e Mbrojtjes (EDIS), gjithashtu nën mbikëqyrjen e instrumentit SAFE.”

Këto hua do të përdoren për “mbështetjen e industrisë evropiane të mbrojtjes” përmes “prokurimeve të përbashkëta”, të cilat duhet të përfshijnë të paktën dy vende – ku njëri prej tyre duhet të jetë një shtet anëtar i BE-së.

Shteti tjetër mund të jetë:

- Një tjetër shtet anëtar i BE-së,
- Një vend anëtar i EFTA-s (Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë),
- Një vend anëtar i EEA-s (Zonës Ekonomike Evropiane),
- Ukraina.

(EFTA dhe EEA janë aleanca ekonomike më të gjera se BE-ja, që përfshijnë vende jashtë Unionit si Norvegjia, Islanda dhe Zvicra.)

Pra, asnjë përfshirje e Shteteve të Bashkuara. Përkundrazi, prokurimet e përbashkëta, veçanërisht për blerjen e “municioneve ose për lëvizshmërinë ushtarake”, duhet të përputhen me kërkesat e programit EDIRPA (Instrumenti Evropian për Prokurimin e Mbrojtjes).

Ky program “synon të inkurajojë shtetet anëtare të blejnë së bashku produkte mbrojtëse” dhe “të forcojë bazën teknologjike dhe industriale të mbrojtjes evropiane (EDTIP)”. Partnerët shtesë që mund të integrohen në një plan prokurimi të përbashkët duhet:

- Të kenë një marrëveshje me BE-në, ose
- Të jenë vende kandidatë për anëtarësim në BE, si Turqia.

Financimi dhe burimet

Pjesa tjetër e planit mbështetjet në disa masa kryesore:

- Rritjen e investimeve në

mbrojtje përmes buxhetit të BE-së.

- Rritjen e kapaciteteve të Bankës Evropiane të Investimeve për të mbështetur sektorin e mbrojtjes.

- Përfshirjen e kapitalit privat, veçanërisht përmes zhvillimit të Bashkimit të Kursimeve dhe Investimeve.

Kjo do të arrihet duke ndryshuar rregulloren SFDR (Sustainable Finance Disclosure Regulation), e cila përcakton rregullat mbi financat e qëndrueshme. Këto rregulla do të zbuten për të lejuar financimin e projekteve të mbrojtjes.

Plani i blerjeve të përbashkëta bazohet në shtatë fusha kryesore të investimeve në mbrojtje:

1. Mbrojtja ajrore dhe raketore
2. Sistemet e artilerisë
3. Municionet dhe raketat
4. Dronët dhe sistemet kundër dronëve
5. Lëvizshmëria ushtarake
6. Inteligjenca artificiale, lufta elektronike dhe kibernetike
7. Mbrojtja e infrastrukturave kritike dhe e faktorëve strategjikë.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Hasi emërohet trajner i ri i Anderlechtit

RSC Anderlecht ka vendosur t'i ndajë rrugët me trajnerin David Hubert, i cili e drejtoi këtë ekip për kohësisht nga muaji tetor. E ndërkohë, gjiganti belg e zyrtarizoi sot trajnerin e ri, Besnik Hasi, i cili do ta marrë ekipin në dorë deri në fund të sezonit, me opsion të vazhdimit të bashkëpunimit. Hasi nuk është i huaj në Anderlecht pasi aty e ka shkruar historinë duke qenë lojtar dhe trajner më pas. 53-vjeçari e kishte fituar titullin e kampionit në vitin 2014 dhe e kishte fituar Superkupën e Belgjikës në po atë vit. “E njoh këtë klub dhe pritshmëritë që i ka ky klub. Është nder që edhe një herë ta drejtoj ekipin e parë të Anderlechtit”, ka deklaruar Hasi, dikur përfaqësues dhe kapiten i Kombëtares shqiptare.

Kosova fiton duelin e parë ndaj Islandës

“Epoka e re”

PRISHTINË, 20 MARS - Kosova e ka fituar përballjen e parë ndaj Islandës me rezultat 2-1 në kuadër të “play-off”-it në Ligën e Kombeve. “Në 15 minutat e para të lojës luajtëm mirë dhe kaluam me meritë në epërsi. Por më pas e humbëm kontrollin e lojës pak. Nuk funksionoi ashtu si mendova në fillim. Pas pjesës së parë kemi bërë disa ndryshime. Kemi ndryshuar edhe sistemin e lojës. Jam i lumtur me pjesën e dytë dhe jam i kënaqur me gjithë ekipin. I kishim mundësitë që të shënonim më shumë gola, por Islandës patjetër që i duhet fitorja. Nëse vazhdojmë me lojën e njëjtë si në pjesën e dytë do të jetë e vështirë për Islandën, ndërsa ne synojmë Ligën B”, ka thënë trajneri i Kosovës, Franco Foda. “Dardanët” e nisën ndeshjen duke sulmuar kundërshtarin dhe me këtë e krijuar një epërsi të hershme. Në minutën e 19-të, Lumbardh Dellova realizoi gol të bukur për Kosovën, duke dritëruar tifozët me elegancën e tij. Mirëpo, lojtarët tanë nuk ishin të vëmendshëm, duke pësuar gol pas vetëm tre minutash. Ishte kapiteni, Orri Oskarsson, ai që i barazoi shifrat në 1-1. Vedat Muriqi lëshoi një rast të artë në minutën e 42-të, ku nga afërsia goditi topi mbi portë. Një lajm i hidhur është se Valon Berisha do të mungojë në ndeshjen kthyes si mysafir



i Islandës, pasi mori karton të verdhë, ndërsa kishte një të tillë nga ndeshjet e nëntorit të vitit të kaluar. Kosova riktheu epërsinë në fillim të pjesës së dytë, duke treguar sa shumë e donte fitoren. Elvis Rexhebecaj ishte ai që kaloi Kosovën në epërsi, kur realizoi gol të bukur në minutën e 58-të. Në një kombinim me Vedat Muriqin, Milot Rashica nuk arriti ta mposhte portierin

kundërshtar, duke humbur një mundësi të shkëlqyer për golin e tretë. Lojtarët tanë vazhduan me sulme ndaj defanzivës së Islandës, mirëpo nuk arritën më të shënonin, derisa Aro Muric ishte vendimtar me pritjet e tij gjatë këtij takimi. Të dielën (23 mars), Kosova zhvillon ndeshjen kthyes ndaj Islandës, e vlefshme për kalimin në Ligën B.

SHKURT

Rapidi konfirmon transferimin e Hazrollajt

Futbollisti i Malishevës, Drilon Hazrollaj, prej sezonit të ardhshëm do të luajë në kampionatin e Rumanisë. Në fakt, Hazrollaj do të transferohet te Rapidi i Bukureshtit pasi të gjitha palët tashmë kanë arritur marrëveshjen, e cila do të zyrtarizohet në fund të sezonit. Transferimin e Hazrollajt te Rapidi e ka konfirmuar edhe një nga aksionarët e këtij klubi, Victor Angelescu, por që nuk ka dhënë shumë hollësi. Sipas tij, Hazrollaj është një futbollist fantastik dhe do të jetë përforsim i madh për Rapidin, ekip që synon titullin e kampionit. Megjithatë, Angelescu ka insistuar se Rapidi ka pranuar të paguajë një shumë të mirë parash, por jo 900 mijë euro siç është spekuluar më parë. Hazrollaj 21-vjeçar këtë sezon ka shënuar 9 gola dhe ka bërë 3 asistime në 27 ndeshje të luajtura për Malishevën.

Boksi rikthehet në programin olimpik

Edhe zyrtarisht boksi është rikthyer në programin olimpik. Vendimi është marrë nga sesioni i 144-t i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC), që po mbahet në Costa Navarino të Greqisë. Vendimi u bazua në propozimin e Bordit Ekzekutiv të IOC-së, pas rekomandimit nga Komisioni i Programit Olimpik, dhe njohjes së përkohshme të “World Boxing” si Federata Ndërkombëtare brenda Lëvizjes Olimpikë, që qeveris sportin e boksit në nivel botëror. Pjesë e “World Boxing” është edhe Federata e Boksit e Kosovës, anëtarësim ky që u hapi rrugën boksierëve tanë të kërkojnë kualifikimin në LO LA28. “World Boxing” momentalisht ka 88 federata anëtare.

Ismajli mungon ndaj Anglisë

Qendërmbrojtësi Ardian Ismajli përfundimisht nuk do të jetë në dispozicion të selektorit Sylvinho për ndeshjen kundër Anglisë. Edhe pse udhëtoi me Shqipërinë në Londër, testet mjekësore kanë konfirmuar mungesën e Ismajlit për këtë përballje. Ismajli ka shfaqur probleme muskulore në grumbullimin e Shqipërisë, duke e lënë të përgjysmuar repartin e mbrojtjes. Kështu që, alternativat e Sylvinhos për qendërmbrojtës janë Berat Gjimshiti, Arlind Ajeti e Enea Mihaj. Ndeshja Angli - Shqipëri luhet të premten prej orës 20:45 në stadiumin “Wembley” dhe u takon kualifikimeve për Kupën e Botës 2026.

Përballjet vendimtare në Superligën e Femrave

Prishtinë, 20 mars - Superliga Femrat vazhdon me ndeshje interesante këtë fundjavë, ku zhvillohet java e 18. Kampionati po i afrohet fundit të garave të rregullta dhe çdo ndeshje bëhet gjithnjë e më e rëndësishme. Në parket zhvillohet luftë për çdo top dhe sekondë. Derbi i

javës do të luhet mes vendit të dytë dhe të tretë, ku Peja 03 dhe Prishtina do të përballen në një sfidë ku fitorja është e vetmja alternativë. Të dyja skuadrat kanë nga 10 fitore dhe 7 humbje, duke e bërë këtë duel edhe më vendimtar. Një tjetër sfidë interesante pritet të zhvillohet mes

Bashkimit dhe Junior 06 Moni Bau, në derbin e qytetit në “Sezai Surroi”. Kjo ndeshje pritet të jetë shumë e luftuar, me Bashkimin që kryeson me 17 fitore dhe vetëm një humbje, ndërsa Junior 06 ka 5 fitore dhe 12 humbje. Në Mitrovicë, Trepça do të ndeshet me Penzën, në një

duel ku të dyja skuadrat synojnë fitoren. Trepça ka regjistruar 2 fitore dhe 15 humbje deri më tani, ndërsa Penza ka 8 fitore dhe 9 humbje. Superliga e Femrave: KBF Prishtina - KBF Peja 03, KBF Bashkimi - KBF Junior 06, KBF Penza - KBF Trepça.



Tour de France do të kthehet në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 2027

PARIS, 20 MARS - Për herë të parë Tour de France Femmes do të zhvillohet në Mbretërinë e Bashkuar, ndërkohë që garat e meshkujve kanë pasur dy edicione në tokën britanike, të parat në vitin 2007 dhe të dytat në vitin 2014. Edicioni i 2027-s do t'i përfshijë garat për meshkuj dhe për femra, të cilat

do të zhvillohen në Angli, Skoci dhe Uells. Ky do të jetë hera e parë që të dy Grand Depart (nisjet e mëdha) zhvillohen në të njëjtin vend jashtë Francës. Organizatorët presin që miliona tifozë t'i mbushin rrugët për ta ndjekur garën. Gara për meshkuj do të nisë nga Edinburgu, e me shumë detaje

mbi rrugën pritet të shpallen këtë vjeshtë. Pjesëmarrësit e mëparshëm britanikë kanë përfshirë Sir Bradley Wiggins, Geraint Thomas dhe Chris Froome, që ka fituar katër herë Tour de France. Në garën aktuale Tadej Pogacar nga Sllovenia është kampioni i meshkujve, ndërsa Kasia

Niewiadoma nga Polonia është fituese e edicionit të femrave. Christian Prudhomme, drejtor i përgjithshëm i Tour de France, shprehu kënaqësinë që ky event do të mbahet në Mbretërinë e Bashkuar, duke theksuar se Britania ka mirëpritur gjithmonë garën me entuziazëm dhe krenari. Ai



shpreson që ky bashkëpunim midis Anglisë, Skocisë dhe Uellsit do të bëjë eventin edhe më të veçantë.

Duka për organizimin e ‘Euro 2027’ me Serbinë: Do të shërbejë si nxitje për të thyer barriera

TRANË, 20 MARS - Presidenti i Federatës së Futbollit të Shqipërisë (FSHF), Armand Duka, ka dhënë një intervistë për UEFA-n, duke folur mbi rritjen e jashtëzakonshme të futbollit shqiptar nën udhëheqjen e tij – nga rindërtimi i infrastrukturës sportive të vendit deri te “utopia” e kualifikimit për dy faza finale të EURO-së. Megjithatë, vëmendja jonë është te tema e bashkëpunimit të Shqipërisë me Serbinë për organizimin e Kampionatit Evropian 2027 për U-21. Duka ka treguar se si ka ardhur deri tek aplikimi dhe cila ishte ideja e tij për bashkëpunim me shtetin armik të shqiptarëve, Serbinë. “Fillimi i aplikimit ka qenë individual, por me një lloj pragmatizmi rrugës vendosëm t'i bashkonim kandidaturat me Federatën e Serbisë për të pasur më shumë shanse që ta fitonim organizimin e këtij turneu”, ka



thënë fillimisht Duka. “Shqipëria nuk ka organizuar kurrë më parë një turne sporti të një niveli kaq të lartë. Ne do t'i presim finalen e Kampionatit Evropian U-17 në maj këtë vit, që gjithashtu është një kompeticion i rëndësishëm, por pritja e finaleve të Kampionatit Evropian U-21 është një nivel shumë më i lartë”.

“Benefitet e Shqipërisë janë të shumta, që nga pjesëmarrja e Kombëtares tonë U-21 për herë të parë në finalen e një Evropiani e për të vijuar me përmirësimet në infrastrukturë që do të sjellë ky turne. Do të ketë përfitime ekonomike veçanërisht në drejtim të turizmit”. “Në fund, por jo për nga rëndësia, mendoj se mesazhet që ne i japim botës me këtë organizim janë shumë të mëdha. Kampionati Evropian U-21 2027 do të jetë më shumë sesa një turne futbollit. Do të shërbejë si nxitje për të thyer barriera, për ta forcuar mirëkuptimin e ndërsjellë dhe për të krijuar një të ardhme më pozitive për popujt e Ballkanit dhe do të tregojë se çfarë mund të arrihet kur njerëzit bashkohen rreth një objekti të përbashkët, të frymëzuar nga fuqia e futbollit”, ka përfunduar i pari i FSHF-së.

Oklahoma merr kreun e renditjes, lakersat fitojnë duelin ndaj Denverit



OKLAHOMA, 20 MARS - Oklahoma ka marrë kreun e renditjes në NBA pas fitores me rezultat 133-100 ndaj Philadelphia's. Ndeshje e komanduar nga vendësit, me shtatë lojtarë që realizuan mbi 10 pikë. Aaron Wiggins me 26 pikë ishte më i miri në fushë. Humbja e tretë radhazi për Clevelandin, që u mund me rezultat 123-119 nga Sacramento, por mbron

kreun e renditjes në Lindje. DeRozani me 27 pikë ishte lider për Sacramento, ndërkohë që Cavaliersi duket se ka hyrë në një krizë rezultatesh. Fitorja e tretë radhazi për lakersat, që mundën me shifrat 120-108 Denverin, një përballje mes dy ekipesh pretendente në Perëndim. Luka Doniqi me 31 pikë u dallua në fushë,

REZULTATET		
Indiana - Dallas		135-131
Orlando - Houston		108-116
Miami - Detroit		113-116
Minnesota - New Orleans		115-119
Oklahoma - Philadelphia		133-100
San Antonio - New York		120-105
Utah Jazz - Washington		128-112
Lakers - Denver		120-108
Phoenix - Chicago		127-121
Portland - Memphis		115-99
Sacramento - Cleveland		123-119

mbështetur edhe nga Reaves me 22 pikë. Tjetër humbje për Miamin, që u ndal me rezultat 116-113 nga Detroiti. Të gjithë titullarët e Pistonsit realizuan mbi 10 pikë. Zhgënjeu edhe Dallasi, që u mund me rezultat 135-131 nga Indiana (Siakam 29 pikë), ndërsa Phoenixi mundi me rezultat 127-121 Chicagon (Booker 41 pikë).

SHKURT

Manaj pritet të transferohet te Trabzonspori

Rey Manaj mbetet një nga sulmuesit më të vlerësuar në Turqi. Emri i “bomberit” kuqezi mbetet fiks në tregun e transferimeve dhe, sipas të gjithë gjasave, ku pritet të jetë sezoni i tij i fundit me ekipin e Sivassporit, pavarësisht se në janar rinovoi kontratën aktuale deri më 2026. Mediet vendase shkruajnë se Manaj po ndiqet nga disa prej klubeve më të mëdha në Turqi, por vetë sulmuesi shqiptar, me sa duket, ka zgjedhur ta vijojë karrierën tek ekipi i Trabzonsporit. Manaj ka dhënë pëlqimin për një transferim të tillë, ndërsa pritet që të arrihet edhe një akord me ekipin e Sivassporit, për të vënë në jetë një lëvizje të tillë. Manaj ka realizuar 8 gola këtë sezon, ndërsa pritet të zbres si titullar edhe në “Wembley”, me trajnerin Sylvinho që beson shumë tek aftësitë e tij.

Martinezi humbet ndeshjen ndaj Uruguait dhe Brazilit

Lajme jo të mira në skuadrën e Interit. Lautaro Martinez do ta lërë grumbullimin me kombëtaren argjentinase, duke humbur kështu të dyja sfidat e marsit me kampionët e botës në fuqi, ato ndaj Uruguait dhe Brazilit. Shkak është bërë një dëmtim muskolor i sulmuesit të Interit në bicepsin femoral. Sipas “La Gazzetta dello Sport”, Lautaro do të rikthehet në Milano, aty ku do të mbahet i observuar nga mjekët e skuadrës së Interit, ku do t'u nënshtrohet vizitave mjekësore për ta kuptuar më shumë gjendjen e tij dhe se kur mund të rikthehet të jetë i gatshëm për trajnerin Simone Inzaghin.

Gasperini do të largohet nga Atalanta, nuk mungojnë ofertat

E ardhmja e Gian Piero Gasperinit duket larg Atalantës, me trajnerin italian që pritet të largohet në fund të sezonit. Trajneri në fjalë ka tërhequr interesim nga disa klube të huaja. Përveç Juventusit dhe Romës, për trajnerin 67-vjeçar janë interesuar edhe klube nga Arabia Saudite, Franca dhe Portugalia. Roma mbetet skuadra favorite, pasi Claudio Ranieri do të largohet në fund të sezonit. Atalanta aktualisht është e treta në Serinë A, 6 pikë prapa Interit kryesues. Skuadra tashmë është eliminuar si nga Coppa Italia ashtu edhe nga Liga e Kampionëve.

Japonia kualifikohet në Botërorin 2026

Japonia është bërë vendi i parë që ka siguruar biletën për në Kampionatin Botëror të vitit 2026. Të enjten Japonia mposhti 2:0 Bahrejin për ta siguruar biletën për në Botërorin që do të mbahet vitin tjetër në ShBA, Meksikë dhe Kanada. Daichi Kamada (66') e Takefusa Kubo (87'), shënuan golat për triumfin e Japonisë. Në 7 ndeshje të kualifikimeve të Azisë, Japonia ka shënuar 6 fitore e 1 barazim dhe renditet e para në tabelë e 19 pikë të mbledhura. Kjo do të jetë hera e tetë që japonezët do të luajnë në ngjarjen madhore të futbollit.

WBC i hap derën rikthimit të Tyson Fury: Gati t'i ofrojmë duelin për titullin e përkohshëm

Nëse Tyson Fury do të ndryshonte mendje për tërheqjen nga sporti dhe do të rikthehej në ring, WBC do t'i ofronte menjëherë mundësinë që të duelonte për titullin e përkohshëm kampion bote në peshën e rëndë ndaj Agit Kabayel.

Këtë gjë e konfirmoi për mediet presidenti i WBC-s, Mauricio Sulaiman. Në rast se Fury do të refuzojë, atëherë ka gjasë që Kabayel të urdhërohet të duelojë me kampionin aktual, ukrainasin Oleksandr Usyk. Presidenti i WBC-s, Mauricio

Sulaiman, ka thënë për “Sky Sports”: “Ne kemi qenë shumë fleksibël dhe mbështetës të konceptit të padiskutueshëm. Ne luftuam shumë për të arritur te titulli i padiskutueshëm në peshën e rëndë dhe nuk i imponuam asnjë detyrim Fury”.

Sulaiman beson se mbajtja e brezit të përkohshëm të peshave të rënda mund ta çojë Kabayel në luftime të mëdha. Ai sugjeron emra si Anthony Joshua, Deontay Wilder ose Tyson Fury nëse ai vendos ta anulojë pensionin e tij dhe të rikthehet në ring. “Unë fola me

Furn. Ai më tha se është në pension dhe unë e përgëzoja, por boksierët kanë diçka. Është shumë e vështirë të largohesh mënjatë përgjithnjë. Nëse ai do të ndryshojë mendje dhe do të rikthehet do ta mbështes për titullin”, ka deklaruar Sulaiman.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Komuna e Gllgocit
Opština Gillogovac-Municipality of Gillogoc



KOMISIONI KOMUNAL I AKSIONARËVE DRENAS

Komisioni Komunal i aksionareve i ndërmarrjes publike lokale KRM" Pastrimi" në Drenas në mbledhjen e mbajtur më 11/03/2025, në bazë të nenit 16, 17 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrje Publike i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr .05/L-009, shpallë këtë:

KONKURS

Për zgjedhjen e 1 anëtarë në Bordit të Drejtorëve të KRM"Pastrimi" Sh. A. Prishtinë
Mandati i anëtareve të bordit është në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrje Publike i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-1 II dhe Ligjin Nr.05/L-009

KUALIFIKIMET DHE PËRGATITJA PROFESIONALE

Çdo person i cili dëshiron të merret parasysh për një pozitë të drejtorit duhet që po ashtu t'i përmbushë edhe kushtet e përshtatshmërisë profesionale në vijim:

- a) të jetë person që ka integritet të njohur, duke marrë parasysh, ndër tjera, çfarëdo shkelje materiale të detyrave fiduciare që mund të ketë bërë ky person ndaj cilit do person tjetër;
- b) duhet ose (i) të ketë së paku pesë (5) vite përvojë - së paku në një nivel të lartë të menaxhmentit në fushën e administrimit të biznesit, financave korporative, financa, menaxhim i thesari, banka, konsulentë në biznes ose industri ose nga një fushë tjetër e shkencës ose njohurisë e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP-së; ose (ii) për së paku pesë (5) vite, të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlidhet ngushtë me veprimtarinë afariste të NP-së.

Kandidatët nuk mund të zgjidhen në bordin e N.P-së nëse:

- a) Aktualisht është zyrtar ose menaxher i NP-së përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, ose ka shërbyer si zyrtar ose menaxher i NP-së përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj brenda pesë (5) vitet e fundit
- b) Aktualisht është punonjës i nivelit të lartë i NP-së përkatëse, ose ka shërbyer si punonjës i nivelit të lartë në NP-në përkatëse brenda tri (3) vitet e fundit
- c) Aktualisht ka, ose gjatë tri viteve të kaluara ka pasur, çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (përveç si konsumator individual i shërbimeve të NP-së) me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;
- d) Është aksionar, drejtor, zyrtar ose punonjës i lartë në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik i cili ka marrëdhënie materiale afariste me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- e) Pranon, ose ka pranuar brenda tri (3) viteve të kaluara, kompensim shtesë nga NP përkatëse ose cilado nga filialet e saj (përveç honorarit të Drejtorit ose kompensimit stimulues të përcaktuar në nenin 20.1, ose është anëtar në skemën pensionale të NP-së përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- f) Mban drejtorë si të ndërsjellë ose ka lidhje të konsiderueshme me drejtorët e tjerë të NP-së përkatëse përmes përfshirjes në shoqëri tjera tregtare ose organe
- g) Përfaqëson në aksionar i cili posedon dhjetë përqind (10%) të aksioneve votuese në NP-në përkatëse
- h) Ka shërbyes në Bordin e Drejtorëve të NP-së përkatëse më shumë se nëntë (9) vite nga data e zgjedhjes së parë të tij/saj;
- i) Është i afërm i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e "Interesit Financiar" në nenin 2 të këtij ligji) i cilitdo person që i takon cilëndo nga kategoritë më sipër përveç personit të përcaktuar në pikën (b)
- j) Është ose (i) punonjës, zyrtar, drejtor ose aksionari, ose ka një Interes Financiar në, një shoqëri tregtare të pa-listuar dhe që konkurron me Ndërmarrjen, ose (ii) menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy përqind (2%) të të drejtave të volimit) i, ose ka një Interes të konsiderueshëm Financiar në, cilëndo nga shoqëritë tregtare të listuara që konkurrojnë me Ndërmarrjen
- k) Është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 muajsh para datës së aplikimit ka qenë (1) zyrtar i zgjedhur publik, (ii) i emëruar politik ose (III) bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;
- l) Ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktonte që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutinore, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij fiduciare ndaj Aksionarëve dhe NP-së.

DOKUMENTET PËR PROCEDURËN E KONKURSIT

- Kandidatët për drejtor në Bordin e drejtorëve të NPL, duhet t'i dorëzojnë provat e mëposhtme: 9 -CV-në,
- Letër motivimi,
- Deklaratën nën betim (formular i cili plotësohet në momentin e dokumentacionit) dorëzimit të dokumentacionit
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (Dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së e punës)
- Certifikatën që nuk është nën hetime nga Gjykata kompetente
- Certifikatën e shtetësisë së Kosovës (kopje e letërnjoftimit)

Aplikuesi duhet të përgatisë deklaratën nën betim, në të cilin deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit; pavarësinë dhe përgatitjen profesionale
Çdo informatë e pavërteta material qofte e qëllimshme, në qoftë nga neglizhenca, do të rezultojë me diskualifikime të menjëhershme.
Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet me zarf të mbyllur në zyrën e sekretarit në objektin e kompanisë “PASTRIMI” në Prishtinë. Rr. Tahir Zajmi, nr 5
Të gjitha dokumentacionet e dorëzuara në zarf të hapur nuk do të merren në shqyrtim dhe do të konsiderohen si të pavlefshme.
Afati i konkursit është i hapur 30 ditë data e publikimit në shtypin ditor



Republika Kosovo
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Opština Gillogocit
Opština Gillogovac-Opština Gillogoc



OPŠTINSKA KOMISIJA AKCIONARA DRENAS

Opštinska komis akcionara lokalnog javnog preduzeća KRM "Čišćenje" u Drenasu na sastanku održanom 11/03/2025, na osnovu članova 16, 17 Zakona br. 03/L-087 o javnom preduzeću, sa izmenama i dopunama Zakonom br. 04/L-111 i Zakonom br. 05/L-009, objavljuje sledeće:

TAKMIENJE

Za izbor 1 člana Upravnog odbora KRM "Čišćenje" a.d. Priština
Mandat članova odbora je u skladu sa Zakonom br. 03/L-087 o javnim preduzećima izmijenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L-1 II i Zakonom br. 05/L-009

KVALIFIKACIJE I STRUČNA PRIPREMA

Švaka osoba koja želi da bude uzeta u obzir za poziciju direktora mora takođe ispunjavati sledeće uslove profesionalne podobnosti:

- a) biti osoba priznatog integriteta, uzimajući u obzir, između ostalog, bilo kakvu materijalnu povredu fiducijarnih dužnosti koje je ta osoba možda počinila prema bilo kojoj drugoj osobi;
- b) mora ili (i) ima najmanje pet (5) godina iskustva – najmanje na nivou višeg menadžmenta u oblasti poslovne administracije, korporativnih finansija, finansija, upravljanja trezorom, bankarstva, konsultanata u biznisu ili industriji ili iz druge oblasti nauke ili znanja koja se odnosi na poslovnu aktivnost NP; ili (ii) najmanje pet (5) godina, bili su javni računovođa, kvalifikovani advokat ili kvalifikovani član druge profesije koja je usko povezana sa poslovnom aktivnošću NP.

Kandidati ne mogu biti izabrani u odbor NP ako:

- a) Za potrebe ove Uredbe, nadležni organ država članica osigurava da nadležni organi dotičnih država članica mogu obavljati svoje zadatke u skladu sa odredbama ove Uredbe.
- b) Trenutno je zaposleni na visokom nivou u relevantnom NP, ili je služio kao zaposleni na visokom nivou u relevantnom NP u poslednje tri (3) godine
- c) Trenutno ima, ili je tokom prethodne tri godine imao, bilo kakav materijalni poslovni odnos (osim kao pojedinačni kupac usluga NP) sa relevantnim NP ili bilo kojom od njegovih podružnica, bilo direktno ili indirektno;
- d) Da li je akcionar, direktor, službenik ili viši zaposleni u komercijalnom preduzeću ili drugom pravnom licu koji ima materijalne poslovne odnose sa relevantnim NP ili bilo kojom od njegovih podružnica;
- e) prihvata, ili je primio u prethodne tri (3) godine, dodatnu naknadu od relevantnog NP ili bilo koje od njegovih podružnica (osim naknade direktora ili podsticajne naknade utvrđene u članu 20.1, ili je član penzionog programa relevantnog NP ili bilo koje od njegovih podružnica;
- f) Zadržava direktore kao međusobne ili ima značajne veze sa drugim direktorima odgovarajućeg NP kroz učešće u drugim komercijalnim kompanijama ili organizama
- g) Predstavlja kao akcionar koji poseduje deset odsto (10%) akcija sa pravom glasa u odgovarajućem NP
- h) Služio je u Upravnom odboru odgovarajućeg NP više od devet (9) godina od dana njegovog / njenog prvog izbora;
- i) Da li je srodnik trećeg stepena (kako je utvrđeno u skladu sa definicijom "finansijskog interesa" iz člana 2. ovog zakona) bilo koje osobe koja pripada bilo kojoj od gore navedenih kategori, osim lica definisanog u tački (b)
- j) Da li je ili (i) zaposleni, službenik, direktor ili akcionar, ili ima finansijski interes u komercijalnoj kompaniji koja nije na listi i koja se takmiči sa Kompanijom, ili (ii) viši manager, službenik, direktor ili akcionar (koji poseduje više od dva odsto (2%) glasačkih prava) ili ima značajan finansijski interes za, bilo koja od navedenih komercijalnih kompanija koja se takmiče sa preduzećem
- k) Da li je ili u bilo kom trenutku tokom perioda od 36 meseci pre datuma podnošenja prijave bio (1) javno izabrani zvaničnik, (ii) politički imenovani ili (III) nosilac rukovođeće position ili position donošenja odluka u političkoj stranci;
- l) Postoji bilo kakav sukob interesa koji bi po svojoj prirodi uzrokovao da ta osoba ne bude u stanju da rutinski, verno, nezavisno i objektno ispunjava svoje fiducijarne dužnosti prema shared-in NP.

DOCUMENTS ZA TENDERSKU PROCEDURU

- Kandidati za direktora u Upravnom odboru NPL-a moraju dostaviti sljedeće dokaze: 9 -CV,
- Motivaciono pismo,
- Izjava pod zakletvom (obrazac koji se popunjava u trenutku dokumentacije) za podnošenje dokumentacije
- Dokumentacija predviđena uslovima zaposlenja (dokaz o stručnoj osposobljenosti, radnom iskustvu)
- Potvrda koja nije pod istragom nadležnog suda
- Potvrda o državljanstvu Kosova (copy lične map)

Podnosilac zahteva mora da pripremi izjavu pod zakletvom, u kojoj izjavljuje da ispunjava uslov kvalifikacije; Samostalnost i profesionalna priprema

Švaka materijalna neistina, bilo namerna ili nemarna, rezultiraće trenutnim disqualifiacijama.

Popunjena dokumentacija mora biti dostavljena u zapečaćenoj koverti u kancelariju sekretara u prostorijama preduzeća "PASTRIMI" u Prištini. Ul. Tahir Zajmi, br. 5

Sva dokumentacija dostavljena u otvorenoj koverti neće se razmatrati i smatraće se nevažećom.

Rok za raspisivanje konkursa je otvoren 30 dana od dana objavljivanja u dnevnoj štampi



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT



SWISS
TAVERNA



Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

A full-page advertisement for 'Lume's Details'. The background features a close-up of a woman's legs, with one leg crossed over the other. The text 'Lume's Details' is written in a large, elegant, black cursive font at the top. Below it, 'Estetik & Depilim' is written in a smaller, black cursive font, with a large, stylized yellow ampersand between the words. To the right of the text, there are three small, square inset images: the first shows a hand applying wax to a leg, the second shows a hand using a wax strip on a leg, and the third shows a hand applying polish to a toe. At the bottom, there is a contact information section with icons for WhatsApp, Facebook, and Instagram, followed by the phone number '044 900 978 | 045 681 898', the Facebook page name 'Sallon Depilimi Lume's Details', the Instagram handle 'lumesdetails', and the address 'Mbrapa Teatr it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi'.

**KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE “ PASTRIMI” SH.A**

Njoftim për vazhdim të afatit të konkursit

KRM “Pastrimi” më datën 07.03.2025 ka hapur konkursin për pozitën “Inkasant” dhe është mbyllur në datën 21.03.2025.

KRM “Pastrimi” vazhdon afatin e konkursit publik për pozitën Shef i Kabinetit të Kryeshefit Ekzekutiv deri më datën 26.03.2025.

Obaveštenje o produženju konkursnog roka

KRM „Pastrimi“ je 07.03.2025 godine otvorio konkurs za poziciju šefa Kabineta glavnog izvršnog direktora i isti je zatvoren 21.03.2025.

KRM „Pastrimi“ nastavlja rok za raspisivanje javnog konkursa za funkciju šefa Kabineta glavnog izvršnog direktora do 26.03.2025.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Xhevat Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Faik Ispahiu shpall të pavlefshme diplomën e nivelit Bachelor të lëshuar më datën 20.05.2003, nr.78 në degën e artit dramatik, drejtimi regjisor, në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës. Diploma është lëshuar nga UNMIK-u dhe UP-ja.
- Fikrete Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Kongresi i Manastirit” Damjan Gjakovë.
- Safete Gjuraj Gërqin Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat nga kl. 1-8 të sh.f.m.u. “7 Shtatori” Gërqin Gjakovë.
- Remzi Krasniqi nga Damjani Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Kongresi i Manastirit” Damja Gjakovë nga kl. 1-8.
- Burim Krasniqi nga Damjani Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u.” Kongresi i manastirit” Damjan Gjakovë nga kl. 1-8.
- Xhevdet Krasniqi Damjani Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u.”Kongresi i manastirit” Damjan Gjakovë nga kl. 1-8.
- Leonita Luma nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh. Ekonomike “Kadri Kusari”.
- “Archihaus” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811902487.
- “Grindelwald Holding” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811898123.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

